




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b), neni 40 shkronja(l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008), nenit 5 nënparagrafi 1.2. dhe nenet 10, 11, 16 dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, datës 31.07.2013 si dhe Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, nenit 25 pika 5 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01 Nr. V-2 datë 04. 05. 2010, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2018, merr këtë:

V E N D I M

PËR HARTIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË DEÇANIT

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Deçanit.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Harta Zonale e Komunës në harmoni me ligjin si: "Një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare."

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Hartën Zonale të Komunës nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohen kushtet zhvillimore hapësinore dhe kushtet ndërtimore për zonat e përcaktuara urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimit të tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Deçanit, me qëllim të plotësimit të kërkesave të reja ligjore për të përgatitur Hartën e detyrueshme multi-sektoriale, e cila përcakton zhvillimin e zonës urbane dhe rurale, me qëllim që në mënyrë cilësore të trajtojë edhe zonat rurale që nuk ka qenë e kërkuar më parë.

		HYRËSE-ULAZNA-INGOING	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA		KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DEÇAN MUNICIPALITY	
Nga:	00:	Nr. Prot:	3515
01:	02:	Br. Prot:	Prot. No.
03:	04:		
Nr. Ishaqev:	01	Data:	05-02-18
Br. Stranica:			

Neni 4

Kufiri i territorit

Në territorin e Komunës së Deçanit janë të përfshira këto Zonat Kadastrale:

Nr.	Zona Kadastrale	Shifra	ha	a	m2
1.	Baballoq,	70505002	506	93	47
2.	Beleg,	70505004	224	58	39
3.	Belle, (Isniq)	70511038			
4.	Carrabreg i Epërm,	70505080	603	91	52
5.	Carrabreg i Ulët, (Carrabreg i E.)	70505080			
6.	Dashinoc,	70505019	755	91	41
7.	Deçan,	70505021	2829	15	18
8.	Drenoc,	70505026	556	87	95
9.	Dubovik,	70511031	321	30	63
10.	Dubravë, (Shaptej)	70505082			
11.	Glllogjan,	70505013	645	38	09
12.	Gramaqel,	70505016	454	17	52
13.	Hulaj	70505078	2138	33	46
14.	Irzniq I,	70505068	613	99	33
14/a.	Irzniq II,	70505069	3226	02	68
15.	Isniq,	70511038	6947	78	12
16.	Kodralli,	70505040	265	75	12
17.	Lëbushë,	70511057	332	31	47
18.	Lumbardh,	70505046	533	20	93
19.	Lloqan, (Hulaj)	70505078			
20.	Llukë e Epërme,	70505085	243	48	33
21.	Llukë e Ulët, (Lumbardh)	70505046			
22.	Maznik,	70505047	895	38	70
23.	Papiq,	70511068	103	37	78
24.	Pobergjë,	70505058	1551	16	16
25.	Pozhar,	70505059	178	83	71
26.	Prapaqan,	70511069	371	67	27
27.	Prekolluk, (Irzniq I)	70505068			
28.	Prilep,	70505062	538	15	39
29.	Rastavicë,	70505065	347	13	55
30.	Ratish i Epërm,	70505015	176	42	25
31.	Ratish i Ulët,	70505023	402	48	70
32.	Sllup,	70505072	104	61	28
33.	Strellc i Epërm,	70511022	2224	03	16
34.	Strellc i Ulët,	70511028	454	47	89
35.	Shaptej,	70505082	424	16	77
36.	Voksh,	70505011	425	59	06
37.	Vranoc i Vogël, (Maznik)	70505047			

Gjithësejt:	29396	65	27
--------------------	--------------	-----------	-----------

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Hartës Zonale të Komunës caktohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i Komunës së Deçanit. Harta Zonale e Komunës do të hartohet në bazë të kontratës të lidhur në mes të Komunës së Deçanit dhe kontraktorit që do të përcaktohet nga konkursi i projektimit përmes procedurave të prokurimit publik sipas Ligjit Nr. 03/L-241 Për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartojë në afat prej 28 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultime Publike

Projekti i Hartës Zonale të Komunës para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Hartës Zonale të Komunës në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i Vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Harta Zonale e Komunës hartohet për periudhën kohore së paku 8 (tetë) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jete në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Programi

Pjese e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinorë Nr. 04/L-174.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.I-6

Deçan,dt.31.01.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj